



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim
Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 qershor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIMET	4
A.	Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit.....	4
B.	Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut.....	5
C.	Përgjigjja e ZPS-së	7
D.	Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit.....	9
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE.....	10
IV.	DISKUTIM.....	11
A.	Standardet e përgjithshme lidhur me formën e Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar	11
1.	Konkretësia dhe qartësia	11
2.	Hollësitë	14
3.	Aktakuzë me mangësi.....	15
B.	Kundërshtimet ndaj formës së Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar	16
1.	Leximi i duhur i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar	16
2.	Paraqitja e personave zyrtarë.....	18
3.	Paraqitja e detyrave zyrtare	20
4.	Paraqitja e veprimeve penguese të pretenduara	21
5.	Paraqitja e veprimit të përbashkët.....	23
6.	Paraqitja e sjelljes së z. Fazliu.....	24
7.	Tentativa për pengim: Njoftimi i duhur i z. Fazliu dhe dispozitat ligjore përkatëse	25
V.	VENDIM.....	27

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4), 38(4) dhe 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 86(3), 95(2)(f) dhe 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi, pjesërisht, Aktakuzën ndaj Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Bashkim Smakajt (“z. Smakaj”), Isni Kilajt (“z. Kilaj”), Fadil Fazliut (“z. Fazliu”) dhe Hajredin Kuçit (“z. Kuçi”) (bashkërisht “të akuzuarit”) për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe rendit publik – konkretisht, tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe/ose mosbindje ndaj gjykatës (“Vendimi i Konfirmimit”).²

2. Më 12 shkurt 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) apeloj Vendimin e Konfirmimit,³ me lejen e Gjykatës së Procedurës Paraprake,⁴ dhe më 3 prill 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin mbi apelin e ZPS-së dhe i ktheu Gjykatës së Procedurës Paraprake një aspekt për shqyrtim të mëtejshëm.⁵

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 313. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

³ KSC-BC-2023-12, IA002/F00002, Prokurorja e Specializuar, *Apel i Prokurorisë kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës (F00036)*, 12 shkurt 2025, konfidencial, me Shtojcat 1 dhe 2, publike. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 14 shkurt 2025, IA002/F00002/RED.

⁴ KSC-BC-2023-12, F00149, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Specialist Prosecutor's Request for Leave to Appeal the "Decision on the Confirmation of the Indictment"](#) (Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Leje për Apelin të Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës), 30 janar 2025, publik.

⁵ KSC-BC-2023-12, IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [IA002/F00012/RED](#).

3. Më 14 prill 2025, në vijim të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi Vendimin e Konfirmimit, urdhëroi ZPS-në të dorëzonte Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar dhe i caktoi Mbrojtjes datën për dorëzimin e mocioneve paraprake.⁶
4. Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar (“Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar”).⁷
5. Më 8 maj 2025, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi, ndër të tjera, Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Mangësi në Aktakuzë (“Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit”).⁸
6. Më të njëjtën ditë, Mbrojtja e z. Fazliu (“Mbrojtja e Fazliut”) dorëzoi, ndër të tjera, Kundërshtimin e Mbrojtjes së Fazliut ndaj Formës së Aktakuzës (“Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut”).⁹
7. Më 29 maj 2025, pasi iu miratua zgjatje afati,¹⁰ ZPS-ja dorëzoi përgjigjen përmbledhëse ndaj Mocionit të Mbrojtjes së Thaçit dhe Mocionit të Mbrojtjes së Fazliut (“Përgjigjja e ZPS-së”).¹¹

⁶ KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the “Decision on the Confirmation of the Indictment” and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, [Submission of Amended Confirmed Indictment](#) (Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përmban versionin konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar) dhe [Annex 2](#) (Shtojcën 2), publike (që përmban versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

⁸ KSC-BC-2023-12, F00288, Mbrojtja e Thaçit, [Thaçi Defence Motion on Defects in the Indictment](#) (Mocion i Mbrojtjes së Thaçit për Mangësi në Aktakuzë), 8 maj 2025, publik.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00289, Mbrojtja e Fazliut, [Fazliu Defence Challenge to the Form of the Indictment](#) (Kundërshtim i Mbrojtjes së Fazliut ndaj Formës së Aktakuzës), 8 maj 2025, publik.

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00306, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on “Prosecution Request for Extension of Time on Preliminary Motions Responses](#) (Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati për Përgjigjet ndaj Mocioneve Paraprake), 15 maj 2025, publik.

¹¹ KSC-BC-2023-12, F00313, Prokurorja e Specializuar, [Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake për Mangësi në Formën e Aktakuzës](#), 29 maj 2025, publike.

8. Më 3 qershor 2025, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së ZPS-së ("Kundërpërgjigjja e Thaçit").¹²

II. PARASHTRIMET

A. MOCIONI I MBROJTJES SË THAÇIT

9. Mbrojtja e Thaçit parashtron se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar ka mangësi për shkak se i mungon konkretësia lidhur me veprën penale të tentativës për pengim të zyrtarëve publikë, sikurse pretendohet në Pikat 1 deri 3, dhe kërkon që ZPS-ja të urdhërohet ta ndryshojë ose heqë këtë akuzë nga Aktakuza.¹³ Mbrojtja e Thaçit argumenton se, për pasojë, z. Thaçi e ka të pamundur t'i kuptojë dhe t'u përgjigjet këtyre akuzave.¹⁴

10. Së pari, Mbrojtja e Thaçit pretendon se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar nuk paraqet me konkretësi identitetin e zyrtarit ose zyrtarëve publikë, apo të paktën llojin e zyrtarëve që pretendohet se janë penguar në detyrat e tyre. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, referencat ndaj institucionit në përgjithësi apo elementeve materiale të veprës penale në kuptim të nenit 401(2) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Ligji nr. 06/L-074 ("KPK"), janë të pamjaftueshme.¹⁵

11. Së dyti, Mbrojtja e Thaçit pretendon se Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar i mungon konkretësia lidhur me detyrat specifike zyrtare që zyrtari ose zyrtarët pretendohet se u penguan të kryenin, dhe thjesht u referohet objektivave ose

¹² KSC-BC-2023-12, F00321, Mbrojtja e Thaçit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Mocionit Paraprak për Mangësi në Aktakuzë*, 3 qershor 2025, publike.

¹³ Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit, para. 1-2, 9-12, 26-27.

¹⁴ Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit, para. 2, 26.

¹⁵ Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit, para. 13-18, që u referohet para. 23 dhe 25 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar.

rezultateve të përgjithshme që ZPS-ja mund të synojë të realizojë përmes punës së vet.¹⁶

12. Së treti, Mbrojtja e Thaçit pretendon se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar është e mjegullt sa i takon tentativës për sjelljen penguese të pretenduar, pasi në të parashtrohet vetëm se të akuzuarit “u bashkërenduan për të ndikuar [...] në dëshmitarët”, pa shpjeguar se si kjo sjellje “parandaloi, pengoi ose vonoi” personat zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre.¹⁷

13. Së fundi, Mbrojtja e Thaçit pretendon se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar identifikohen tre grupe që pretendohet se kanë vepruar me anë të “veprimit të përbashkët” sipas nenit 401(2) të KPK-së, por nuk shpjegohet se cila sjellje e të akuzuarve përbën veprim të përbashkët.¹⁸

B. MOCIONI I MBROJTJES SË FAZLIUT

14. Mbrojtja e Fazliut parashtron se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar është palejueshmërisht e mjegullt dhe nuk konkretizon mjaftueshëm akuzat ndaj z. Fazliu dhe faktet materiale ku ato mbështeten, dhe se, për pasojë, z. Fazliu nuk është në gjendje të përgatisë si duhet mbrojtjen e tij.¹⁹ Mbrojtja e Fazliut kërkon që ZPS-ja të urdhërohet ta ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar në mënyrë që të japë më shumë konkretësi dhe qartësi për secilën prej mangësive të mëposhtme.²⁰

15. Së pari, Mbrojtja e Fazliut argumenton se, meqenëse z. Fazliu akuzohet për përfshirje të drejtpërdrejtë në tentimet për të ndërhyrë te dëshmitari 1, ZPS-ja nuk shpreh qartë pretendimet faktike ndaj z. Fazliu në lidhje me dëshmitarin 1, veçanërisht: (i) sjelljen e z. Fazliu gjatë takimit të 29 qershorit 2023; (ii) praninë e z.

¹⁶ Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit, para. 19-20, që i referohet para. 25 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar.

¹⁷ Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit, para. 21-22.

¹⁸ Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit, para. 23-25.

¹⁹ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 1-2, 11.

²⁰ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 2, 19.

Fazliu në takimin e 3 korrikut 2023, bashkë me Fahri Fazliun dhe dëshmitarin 1; dhe (iii) sjelljen e z. Fazliu gjatë takimit të 3 korrikut 2023.²¹

16. Së dyti, Mbrojtja e Fazliut pretendon se konturet e “veprimit të përbashkët” të një grupi të pretenduar sipas nenit 401(2) të KPK-së, nuk janë të qarta sa u takon zotërinjve Fazliu, Smakaj, Kilaj dhe Kuçi. Sipas Mbrojtjes së Fazliut, formulimi i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar mund të interpretohet se pretendon një bashkërendim më të gjerë ndërmjet të gjithë anëtarëve të grupeve të identifikuara, jo vetëm ndërmjet z. Fazliu dhe z. Thaçi, dhe se kjo paqartësi nuk zgjidhet në fazën e procedurës paraprake.²²

17. Së treti, Mbrojtja e Fazliut pretendon se ZPS-ja nuk paraqet me konkretësi akuzën e *tentativës* për pengim dhe në veçanti, se cili kryes pretendohet të ketë filluar të kryejë cilat elemente materiale dhe si kjo sjellje nuk përbën kryerje të plotë.²³ Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Fazliut argumenton se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar nuk përfshin nenin 28 të KPK-së.²⁴

18. Së fundi, Mbrojtja e Fazliut pretendon se, sipas Pikës 16 të Aktakuzës, duke qenë se ZPS-ja pretendon se të akuzuarit ndihmuan brenda secilit grup dhe ndërmjet grupeve përkatëse, ZPS-ja nuk vë në dukje asnjë komunikim apo veprim ndërmjet grupeve.²⁵ Mbrojtja e Fazliut argumenton se ZPS-ja duhet të identifikojë qartë veprimet përkatëse ose praktikën e sjelljes përkatëse që pretendohet se ka kryer z. Fazliu, përfshirë orën, vendin dhe mjetet me të cilat është dhënë ndihma e pretenduar ndërmjet grupeve.²⁶

²¹ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 9-11.

²² Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 12-14.

²³ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 15.

²⁴ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 16.

²⁵ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 17-18.

²⁶ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 18.

C. PËRGJIGJJA E ZPS-SË

19. ZPS-ja përgjigjet se faktet materiale në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje janë paraqitur në mënyrë të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, që u mundëson të akuzuarve të kuptojnë akuzat dhe përgatisin mbrojtjen. Rrjedhimisht, ZPS-ja propozon që mocionet paraprahe të z. Thaçi dhe z. Fazliu të rrëzohen në tërësinë e tyre.²⁷

20. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se ZPS-ja nuk paraqet identitetin e zyrtarit ose zyrtarëve publikë, ZPS-ja rikujton se provat e ZPS-së nuk lidhen me ndonjë zyrtar të caktuar. Sipas ZPS-së, referenca ndaj kategorisë së zyrtarëve të penguar – konkretisht gjykatësve, prokurorëve, zyrtarëve të gjykatës, zyrtarëve të prokurorisë dhe personave të tjerë të autorizuar nga Dhomat e Specializuara (“DHS”) ose ZPS-ja – është e mjaftueshme për t’i mundësuar z. Thaçi t’i kuptojë akuzat.²⁸

21. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se ZPS-ja nuk argumenton natyrën e detyrave zyrtare, ZPS-ja përgjigjet se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar identifikohen si duhet detyrat e zyrtarëve si “aftësi[a] për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në mënyrë efektive, përfshirë aftësi[a] e [DHS-së]/ZPS-së për të marrë dhe mbrojtur prova relevante të dëshmitarëve”.²⁹

22. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se ZPS-ja nuk paraqet me saktësi pengimin e detyrave zyrtare, ZPS-ja përgjigjet se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar “pretendohet qartë se përpjekjet për të ndikuar në mënyrë të paligjshme të dëshmitarët synonin të pengonin Çështjen 6 dhe të komprometonin aftësinë e [DHS-së]/ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në mënyrë efektive”.³⁰

²⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 17.

²⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 6-8.

²⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 9.

³⁰ Përgjigjja e ZPS-së, para. 10.

23. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se ZPS-ja nuk paraqet me saktësi sjelljen e të akuzuarve që rezulton në veprimin e përbashkët për pengim, ZPS-ja argumenton se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar identifikohet sjellja e të gjithë të akuzuarve brenda grupeve të tyre përkatëse. Gjithashtu, sipas ZPS-së, ky interpretim nuk merr parasysh se “veprimi i përbashkët” mund të përfshijë çdo veprimtari që ndërmerret bashkërisht nga pjesëtarët e grupit, pa kufizime në lidhje me formën.³¹

24. Sa i takon referencës së Mbrojtjes së Fazliut për “konturet e paqarta të veprimit të përbashkët” ose “ndihmën ndërmjet grupeve”, ZPS-ja fillimisht sqaron se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar nuk përfshin akuzë për veprime që lidhen me bashkërendimin brenda dhe ndërmjet grupeve të ndryshme, por artikulon qartë akuzat kundër të akuzuarve dhe bën dallimin midis grupeve përkatëse të cilëve u përkisnin të akuzuarit.³²

25. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Fazliut se ZPS-ja nuk paraqet me saktësi veprimet e z. Fazliu në lidhje me dëshmitarin 1, ZPS-ja argumenton se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar përfshin në mënyrën e duhur faktet materiale ku mbështeten akuzat dhe përmbledh faktet e përshkruara.³³

26. Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Fazliut se ZPS-ja nuk paraqet me saktësi faktet ku mbështetet akuza e *tentativës* për pengim, ZPS-ja argumenton se nuk i kërkohet të paraqesë se si faktet mbi të cilat mbështetet akuza në fjalë, i përmbushin apo jo kriteret e veprave penale të tjera apo formave të tjera të përgjegjësisë.³⁴ Sa i takon pretendimit për mospërfshirjen e nenit 28 të KPK-së në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar në kontekstin e akuzës për tentativë për pengim, ZPS-ja

³¹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 11.

³² Përgjigjja e ZPS-së, para. 13.

³³ Përgjigjja e ZPS-së, para. 14.

³⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 15.

përgjigjet se ky pretendim përbën kundërshtim ndaj elementeve përbërëse të tentativës për pengim, që është një aspekt që do të shqyrtohet gjatë gjykimit.³⁵

D. KUNDËRPËRGJIGJJA E MBROJTJES SË THAÇIT

27. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se, në përgjigjen e vet, ZPS-ja thjesht u referohet pjesëve të mëdha të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar ose jep shpjegime apo përkufizime të elementeve (të kundërshtuara) të veprave penale.³⁶ Konkretisht, sa i takon identifikimit të personave zyrtarë, Mbrojtja e Thaçit pretendon se ZPS-ja nuk kufizon rrethin e zyrtarëve me të cilët lidhet kjo çështje.³⁷ Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Thaçit pretendon se, në qoftë se ZPS-ja argumenton se tentativa për pengim është kryer në përgjithësi kundër administrimit të drejtësisë dhe jo kundër ndonjë zyrtari të caktuar, z. Thaçi dëshiron të bëjë parashtrime më vete në lidhje me nëse ZPS-ja ka ngritur akuza sipas dispozitës së gabuar të KPK-së.³⁸ Mbrojtja e Thaçit pretendon se detyrat zyrtare nuk janë specifikuar mjaftueshëm në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar.³⁹ Në lidhje me elementet e veçanta të pengimit të pretenduar, Mbrojtja e Thaçit përsërit se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar nuk përmban asnjë hollësi specifike, dhe argumenton se duhet ta dijë pse ZPS-ja thotë se sjellja e pretenduar në këtë çështje do të kishte shkaktuar pengim të zyrtarëve të ZPS-së ose DHS-së.⁴⁰ Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit përsërit kërkesën që, duke mbajtur parasysh mangësitë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake të urdhërojë ZPS-në të ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar ose të heqë akuzat për pengim të personave zyrtarë.⁴¹

³⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 16.

³⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 2-3.

³⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 6-7.

³⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 16.

³⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 10-11.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 12-15.

⁴¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 17.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

28. Në bazë të nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë për të marrë vendim në lidhje me çdo mocion paraprak, përfshirë kundërshtimet ndaj Aktakuzës.

29. Në bazë të rregullës 97(1)(b) të Rregullores, në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, i akuzuari mund t'i paraqesë mocione paraprake Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të cilat pretendojnë mangësi në formën e Aktakuzës.

30. Në bazë të rregullës 95(2)(f) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, vendos në lidhje me mocione paraprake të dorëzuara sipas rregullës 97 të Rregullores para se dosja e çështjes gjyqësore t'i kalohet Trupit Gjykses.

31. Në bazë të nenit 21(4)(a) të Ligjit, i akuzuari njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij.

32. Në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, Aktakuza duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një përshkrim të shkurtër të fakteve të çështjes dhe të veprës ose veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari, dhe në veçanti formën e përgjegjësisë penale të pretenduar në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet. Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, d.m.th. provat në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME FORMËN E AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR TË NDRYSHUAR

1. Konkretësia dhe qartësia

33. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me nenet 21(4)(a) dhe 38(4) të Ligjit, si edhe me rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të paraqesë me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme faktet në të cilat mbështeten akuzat për vepra penale, përfshirë format e përgjegjësisë penale të përfshira në aktakuzë.⁴² Kjo konkretësi dhe qartësi duhet të sigurojë që aktakuza, si dokument i pavarur,⁴³ t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje

⁴² KSC-BC-2023-10, F00221, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Motion Challenging the Form of the Confirmed Indictment](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Konfirmuar) ("Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10"), 19 mars 2024, konfidencial; KSC-BC-2020-06, IA012/F00015/RED, Gjykata e Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Defence Appeals Against Decision on Motions Alleging Defects in the Form of the Indictment](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës) ("Vendimi i Apelit në Çështjen 06"), 22 gusht 2022, publik, para. 17; KSC-BC-2020-04, IA004/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Pjetër Shala's Appeal Against Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit në lidhje me Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës) ("Vendimi i Apelit në Çështjen 04"), 22 shkurt 2022, publik, para. 15; KSC-BC-2020-06, F00413/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Defence Motions Alleging Defects in the Form of the Indictment](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës) ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06"), 22 korrik 2021, publik, para. 27; KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on the Defence Appeals Against Decision on Preliminary Motions](#) (Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake) ("Vendimi i Apelit në Çështjen 07"), 23 qershor 2021, publik, para. 35; F00147, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Preliminary Motions](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet Paraprake) ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07"), 8 mars 2021, publik, para. 38.

⁴³ KSC-BC-2023-12, F00004/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Order to the Specialist Prosecutor Pursuant to Rule 86\(4\) of the Rules](#) (Versioni i Redaktuar Publik i Urdhrit Prokurorës së Specializuar sipas Rregullës 86(4) të Rregullores) ("Urdhri sipas Rregullës 86(4)"), 22 shkurt 2024, publik, para. 13; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 38.

adekuate.⁴⁴ Rrjedhimisht, i akuzuari nuk duhet të ketë nevojë të shohë dokumente të tjera që të kuptojë dhe të lidhë në tërësi pretendimet faktike mbi të cilat bazohen akuzat.⁴⁵

34. Konstatimi nëse një fakt mbështet një akuzë të caktuar dhe, rrjedhimisht, duhet paraqitur në aktakuzë me konkretësi, nuk mund të bëhet në përgjithësi, por rast pas rasti, duke marrë parasysh, ndër të tjera, natyrën dhe shkallën e veprave penale të parashtruara në aktakuzë, rrethanat e çështjes, afërsinë e pretenduar të të akuzuarit me ngjarjet dhe formën e përgjegjësisë penale të parashtruar në aktakuzë.⁴⁶ Megjithatë, në disa raste, nuk mund të përjashtohet mundësia që disa hollësi të caktuara të çështjes, si numri dhe identiteti i viktimave,⁴⁷ të mbeten të fshehta edhe pas përfundimit të gjykimit.⁴⁸ Gjithsesi, kur shqyrtohet nëse aktakuza i përmbush kushtet e lartpërmendura, aktakuza duhet parë në tërësi dhe paragrafë apo fraza të veçuara duhen lexuar në kuadër të të gjithë dokumentit.⁴⁹

⁴⁴ [Rule 86\(4\) Order](#) (Urdhri sipas Rregullës 86(4)), para. 12. *Shih gjithashtu* [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 36; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 27; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 24.

⁴⁵ [Rule 86\(4\) Order](#) (Urdhri sipas Rregullës 86(4)), para. 13. *Shih gjithashtu* [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 49; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 38; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 27; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 17; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 24.

⁴⁶ [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 38, 42; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 39; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 28 dhe referencat e cituara aty; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 20; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 25.

⁴⁷ [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 28 dhe referencat e cituara aty.

⁴⁸ [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 39; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 28 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 25.

⁴⁹ [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 56; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 39; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 28 dhe referencat e cituara aty; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 17; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 25.

Gjithashtu, duhet bërë qartë dallimi midis fakteve ku mbështeten akuzat, të cilat duhen paraqitur siç përshkruhet më lart, dhe provave të propozuara për t'i vërtetuar këto.⁵⁰ Nuk është e nevojshme që aktakuza të paraqesë provat me të cilat vërtetohen faktet ku mbështeten akuzat.⁵¹ Këto prova do të nxirren në bazë të dispozitave përkatëse. Çdo mosmarrëveshje lidhur me pikat faktike vendoset në fazën e gjykimit dhe jo përmes mocioneve paraprake mbi formën e aktakuzës.⁵² Gjithsesi, kuadri ligjor i DHS-së siguron se, krahas procesit të nxjerrjes së provave, të akuzuarit i vihen në dispozicion në një fazë të hershme edhe hollësi të tjera të provave në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b), në Vendimin e Konfirmimit dhe në parashtrimet e bëra në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores.⁵³

35. Së fundi, kundërshtimet lidhur me elementet juridike të një vepre penale apo të një forme përgjegjësie penale nuk përbëjnë kundërshtime ndaj formës së Aktakuzës, por janë aspekte që trajtohen në fazën e gjykimit.⁵⁴

⁵⁰ [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 38; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 40; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 29 dhe referencat e cituara aty; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 20; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 26.

⁵¹ [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 38; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 40; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 29 dhe referencat e cituara aty; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 20; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 26.

⁵² [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 40; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 29 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 26.

⁵³ [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 40; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 29 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 26.

⁵⁴ [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 30 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 27.

2. Hollësitë

36. Kur pretendohet se i akuzuari i ka kryer personalisht veprimet ku mbështeten veprat penale të përfshira në aktakuzë, është e nevojshme të jepen, aq sa është e mundur dhe me “saktësinë më të madhe”:⁵⁵ (i) identiteti i viktimës (viktimave); (ii) vendi dhe data e përafërt e veprimeve të pretenduara; (iii) mënyra dhe mjetet me anë të të cilave janë kryer; dhe (iv) elementi mendor i lidhur me to.⁵⁶

37. Nga ana tjetër, kur nuk pretendohet se i akuzuari e ka kryer drejtpërdrejt veprën penale ose kur, për nga natyra, vepra penale synon një grup apo bashkësi njerëzish, të akuzuarit duhet t’i jepet sa më shumë informacion i hollësishëm në lidhje me: (i) vendet, kohën dhe (sipas rastit) numrin e përafërt të viktimave; (ii) hollësitë e nevojshme për të kuptuar elementet e veprave penale, si sjellja e pretenduar e të akuzuarit që çoi në përgjegjësi penale, përfshirë, ndër të tjera, kontributin e të akuzuarit në të; (iii) elementin mendor të lidhur me të; dhe (iv) identitetet e bashkëkryesve të pretenduar, në qoftë se dihen.⁵⁷

38. Nuk lejohen formulime të papërcaktuara në lidhje me faktet ku mbështeten akuzat (të tilla si “përfshirë, ndër të tjera”),⁵⁸ veçse kur janë të nevojshme në raste të

⁵⁵ [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 31 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 29. *Për ngjashmëri*, ICTY/TPNJ, *Prokurori k. Shainoviqit dhe të Tjerëve*, IT-05-87-PT, Dhoma Gjyqësore III, *Vendim mbi Mocionin e Ojdaniqit për Mospranim Juridiksioni: Bashkëkryerja e Tërthortë*, 22 mars 2006, para. 23; *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21, Appeals Chamber, *Decision on Application for Leave to Appeal by Hazim Delic (Defects in the Form of the Indictment)*, 6 December 1996, f. 8.

⁵⁶ [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 31 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 29.

⁵⁷ [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 45; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 41; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 32 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 29.

⁵⁸ [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 185; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 39, me referenca të mëtejshme; [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 84; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 44; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 30.

veçanta në bazë të rrethanave të çështjes apo të natyrës dhe shkallës së veprave penale dhe nuk krijojnë paqartësi lidhur me veprat penale për të cilat ngrihen akuzat. Informacioni duhet përshkruar me saktësi dhe plotësi, pa u shpërndarë.⁵⁹ Gjithashtu, kur përcaktohet një kategori e caktuar në lidhje me faktet ku mbështeten akuzat dhe kur përdoret fjala “përfshirë” ose “ndër të cilët” a “ndër të cilat” për të dhënë një listë shembujsh joshterues që bëjnë pjesë në këtë kategori, përdorimi i “përfshirë” lejohet.⁶⁰ Sidoqoftë, kur kategoria nuk përcaktohet, por vetëm i referohet një liste shembujsh joshterues që bëjnë pjesë në këtë kategori, paraprirë nga “përfshirë” ose “ndër të cilët” a “ndër të cilat”, një përdorim i tillë i “përfshirë” ose “ndër të cilët” a “ndër të cilat” nuk lejohet, sepse do të mundësonte në mënyrë të palejueshme që fushëveprimi i kategorisë përkatëse të zgjerohej në fazën e gjykimit.⁶¹

39. Lejohen formulime alternative si “dhe/ose” në qoftë se kanë lidhje me provat që do të shqyrtohen në gjykim⁶² dhe nuk krijojnë paqartësi lidhur me veprat penale për të cilat ngrihen akuzat ose me format e përgjegjësisë penale.⁶³

3. Aktakuzë me mangësi

40. Aktakuza ka mangësi kur nuk paraqet faktet mbi të cilat mbështeten akuzat apo kur i paraqet ato në mënyrë të pamjaftueshme apo të paqartë, duke krijuar

⁵⁹ [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 39, me referenca të mëtejshme; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 30.

⁶⁰ [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 185; [Case 06 Preliminary Motions Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 39; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 30.

⁶¹ [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 39; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 30.

⁶² [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 45, me referenca të mëtejshme; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 31.

⁶³ [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 45, me referenca të mëtejshme; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 31.

paqartësi lidhur me akuzat e parashtruara, përfshirë edhe format e përgjegjësisë, dhe duke dëmtuar mundësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur.⁶⁴

41. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se konstatimet e lartpërmendura do të shërbejnë si bazë dhe orientim për vlerësimin e mëposhtëm të mangësive të pretenduara të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar.

B. KUNDËRSHTIMET NDAJ FORMËS SË AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR TË NDRYSHUAR

1. Leximi i duhur i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar

42. Mbrojtja e Fazliut argumenton se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar formulimi i veprimit të përbashkët është i paqartë pasi konturet e veprimit të përbashkët sipas kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së nuk janë të qarta dhe lejojnë interpretimin se të gjithë anëtarët e grupeve të identifikuar, përfshirë zotërinjtë Fazliu, Smakaj, Kilaj dhe Kuçi, kanë bashkërenduar ndërmjet tyre.

43. Gjykatësja e Procedurës Paraprake para së gjithash rikujton se, kur shqyrtohet nëse të akuzuarit janë njoftuar mjaftueshëm për natyrën dhe shkaqet e akuzave kundër tyre, Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar duhet parë në tërësi dhe paragrafët e veçuar duhen lexuar në kuadër të të gjithë dokumentit.⁶⁵

⁶⁴ [Case 04 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 04), para. 15; [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 38; [Case 07 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 07), para. 46; [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 40 dhe referencat e cituara aty; KSC-BC-2020-06, F00895, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Motion Alleging Defects in the Form of the Amended Indictment](#) (Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar), 22 korrik 2022, publik, para. 19 dhe referencat e cituara aty; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 18-19; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 32.

⁶⁵ *Shih* [Case 04 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 04), para. 18; [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 56 dhe referencat e cituara aty; [Case 10 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në Çështjen 10), para. 25, 39.

44. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se z. Fazliu e lexon në mënyrë të pasaktë Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar.⁶⁶ Në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar thuhet se z. Thaçi, individualisht dhe me anë të veprimit të përbashkët të grupeve në të cilët bëri pjesë – përfshirë, ndër të tjerë, grupin me z. Fazliu (“grupi i Fazliut”) – i ka drejtuar përpjekjet dhe është përfshirë në një praktikë sjelljeje për të penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit të DHS-së, gjatë kohës që mbahej në paraburgim në kontekst të procesit gjyqësor *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* (“Çështja 06”).⁶⁷ Faktet në lidhje me z. Fazliu përshkruhen qartë në paragrafët 9-12 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar që mbulojnë periudhën midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023.⁶⁸ Pika 16 e Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar përfshin qartë dhe shprehimisht përmes referencave faktet midis së paku 26 qershorit 2023 dhe 18 korrikut 2023, që lidhen vetëm me z. Fazliu. Nga ana tjetër, paraqitja e fakteve në lidhje me të akuzuarit e tjerë përmban periudha kohore, vende dhe anëtarë të tjerë të secilit grup përkatës. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në lidhje me këtë aspekt specifik, pas ndërhyrjes gjyqësore të Gjykatësës së Procedurës Paraprake,⁶⁹ ZPS-ja ndryshoi formulimin e akuzave fillestare për pengim të personave zyrtarë dhe në Aktakuzën e Rishikuar paraqiti akuza kundër

⁶⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se Mbrojtja e Fazliut përfshin z. Kuçi kur argumenton mangësitë e Aktakuzës në lidhje me veprën penale të pengimit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake dëshiron të sqarojë se, në kundërshtim me sugjerimin e Mbrojtjes së Fazliut (Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 12-14), z. Kuçi nuk akuzohet për veprën penale të tentativës për pengim sipas kuptimit të nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së. *Shih gjithashtu* Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, para. 23.

⁶⁷ Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar, para. 23.

⁶⁸ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit, para. 114, 126.

⁶⁹ [Rule 86\(4\) Order](#) (Urdhri sipas Rregullës 86(4)), para. 21 (“Si alternativë, nga ZPS-ja kërkohet të rishikojë Aktakuzën për të mundësuar saktësi ligjore ose më shumë qartësi në paraqitjen e akuzave. Në veçanti, nga ZPS-ja kërkohet të shqyrtojë nëse faktet materiale dhe materiali provues të cilat mbështesin, dhe kanë të bëjnë, me secilën prej vizitave të Thaçi, mbështesin paraqitjen e akuzave ndaj z. Thaçi për tri pika të veçanta të pengimit ose tentimit të pengimit, d.m.th secila prej vizitave të Thaçi çoi në veprim të përbashkët të veçantë të udhëhequr nga z. Thaçi, sipas nenit 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së”).

zotërinjve Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj për sjelljen e tyre brenda grupeve të tyre përkatëse.⁷⁰ Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Fazliu rrëzohet.

45. Po kështu, duke qenë se Mbrojtja e Fazliut argumenton se për “ndihmën ndërmjet grupeve” në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar nuk përmenden komunikime apo veprime ndërmjet grupeve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se argumenti i Mbrojtjes së Fazliut bazohet në një lexim të gabuar të dokumentit akuzues.⁷¹ Nuk duhen përcaktuar kritere të tilla sepse ZPS-ja nuk paraqet akuza për veprime që lidhen me bashkërendimin ndërmjet zotërinjve Fazliu, Smakaj dhe Kilaj apo ndërmjet grupeve të tyre përkatëse. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Fazliu rrëzohet.

2. Paraqitja e personave zyrtarë

46. Mbrojtja e Thaçit ankohet se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar nuk identifikon zyrtarët konkretë ose llojet/kategoritë e zyrtarëve (si, për shembull, ekipi hetimor i Çështjes 06), që janë penguar në kryerjen e detyrave zyrtare.

47. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në paragrafin 23 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, ZPS-ja pretendon se zotërinjtë Thaçi, Fazliu, Smakaj, dhe Kilaj janë “përfshirë në një praktikë sjelljeje për të penguar persona zyrtarë, si gjykatës, prokurorë, zyrtarë të gjykatës, zyrtarë të prokurorisë apo persona të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria në kryerjen e detyrave zyrtare”. Nuk jepen

⁷⁰ Krahaso KSC-BC-2023-12, F00002/A01, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimi të Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesës Lidhur me Të*, 15 dhjetor 2023, konfidenciale, para. 20 dhe KSC-BC-2023-12, F00007/A01, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimi të Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim*, 11 mars 2024, konfidenciale, para. 20.

⁷¹ Kjo gjithashtu vetëkuptohet nga leximi i paragrafit 43 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, sa i përket ndihmës si formë e përgjegjësisë penale sipas nenit 33 të KPK-së (“Së fundi, përmes një apo më shumë prej veprimeve të përshkruara në paragrafët 9-12 dhe 16-22 më lart, [z. Smakaj, z. Kilaj, dhe z. Fazliu] ndihmuan brenda secilit grup dhe ndërmjet grupeve të tyre përkatëse, si edhe ndihmuan [zotin Thaçi] në kryerjen e veprave penale të tentativës për pengim të personave zyrtarë dhe mosbindjes ndaj gjykatës, sipas nenit 3 të KPK-së” [theksimi i shtuar]).

emra. Rikujtohet gjithashtu se Aktakuza duhet lexuar në tërësi dhe paragrafë apo fraza të veçuara duhen lexuar në kuadër të të gjithë dokumentit.

48. Duke mbajtur parasysh natyrën e veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, si edhe faktin që ZPS-ja i akuzon zotërinjtë Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj për tentativë për pengim në kontekst të Çështjes 06,⁷² Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se identifikimi i personave zyrtarë të DHS-së dhe ZPS-së të cilëve nuk u përmenden emrat, sikurse përshkruhet në paragrafin 23 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, nuk është palejueshmërisht i megjullt. ZPS-ja lejohet t'i referohet kategorisë së zyrtarëve të ZPS-së ose DHS-së që ka gjasë të kenë pasur pasoja,⁷³ dhe për mendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, emrat konkretë nuk duhen përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar.⁷⁴ Gjithashtu, vlen të rikujtohet se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, zotërinjtë Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj nuk akuzohen për incidente të veçanta që pretendohet se kanë vështirësuar, penguar dhe/ose vonuar punën e zyrtarëve të identifikueshëm të DHS-së ose ZPS-së, si hetuesit apo ekipet e hetuesve. Kjo në fakt është arsyeja pse sjellja e pretenduar e zotërinjve Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj nuk përbënte kryerje të plotë të pengimit dhe cilësohet si *tentativë* për pengim.⁷⁵ Në këto rrethana të veçanta, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se informacioni relevant që përmban Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar, së bashku me hollësitë specifike në lidhje me sjelljen e z. Thaçi gjatë vizitave të caktuara në objektin e paraburgimit të DHS-së, është

⁷² *Shih*, për shembull, Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, para. 7-8; Vendimin e Konfirmimit, para. 113-115, 131, 132, 135, 138, 143, 145, 150, 156, 183.

⁷³ Kjo qasje është pranuar për informacionin në lidhje me kryesit fizikë dhe viktimat. *Shih gjithashtu* [Case 06 Preliminary Motion Decision](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 06), para. 34; [Case 07 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 07), para. 45; [Case 04 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 04), para. 16; [Case 06 Appeal Decision](#) (Vendimi i Apelit në Çështjen 06), para. 72, 106.

⁷⁴ Pasi është informuar për kontekstin specifik të pretendimeve dhe kategorinë e personave zyrtarë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk bindet nga argumenti i Mbrojtjes së Thaçit se nuk mund të kryejë hetime dhe të paraqesë prova relevante (Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 15).

⁷⁵ *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit, para. 189-194.

mjaftueshëm konkret për ta informuar si duhet z. Thaçi në këtë aspekt. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Thaçi është i pabazë.

49. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar akuzon qartë z. Thaçi për tentativë për pengim të personave zyrtarë sipas kuptimit të nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së. Nëse faktet e çështjes përmbushin kriteret ligjore të nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së (apo të një dispozite ligjore tjetër), është një aspekt që do të diskutohet gjatë gjykimit bazuar në provat. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk e gjykon të nevojshme që z. Thaçi të bëjë parashtrime lidhur me cilësimin ligjor të fakteve në këtë fazë.

3. Paraqitja e detyrave zyrtare

50. Mbrojtja e Thaçit ankohet se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar nuk identifikohen detyrat konkrete që pretendohet se janë penguar.

51. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në paragrafin 25 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar thuhet se përmes veprimeve të tyre, zotërinjtë Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj tentuan që të komprometonin “aftësinë e [DHS-së]/ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në mënyrë efektive, përfshirë aftësinë e [DHS-së]/ZPS-së për të marrë dhe mbrojtur prova relevante të dëshmitarëve”. Në kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes së Thaçit, kjo fjali nuk përshkruan thjesht një objektiv, por faktikisht detyrat e zyrtarëve të ZPS-së dhe DHS-së, kryerja e të cilave u tentua të pengohej në kontekst të Çështjes 06.⁷⁶ Sugjerimi i Mbrojtjes së Thaçit për të përfshirë informacion në lidhje me detyrat specifike të zyrtarit në një kohë të caktuar,⁷⁷ është tejet i ngurtë, aq më tepër duke pasur parasysh se zotërinjtë Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj akuzohen për *tentativë* për pengim.⁷⁸ Për mendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, detyrat e personave zyrtarë që veprojnë në

⁷⁶ *Shih më lart* para. 34, 47-48.

⁷⁷ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 11.

⁷⁸ *Shih më lart* para. 48-48.

emër të DHS-së dhe ZPS- së janë shtjelluar mjaftueshëm në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, që për rrjedhojë e informon mjaftueshëm z. Thaçi. Çdo informacion i mëtejshëm do të trajtohet gjatë gjyqimit. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Thaçi është i pabazë.

4. Paraqitja e veprimeve penguese të pretenduara

52. Mbrojtja e Thaçit pretendon se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar është e mjegullt sa i takon pengimit pasi nuk shpjegon se si ndikimi të dëshmitarët do të kishte shkaktuar pengimin e një zyrtari publik. Në kundërpërgjigje, Mbrojtja e Thaçit shton se duket se ZPS-ja argumenton se “çdo kontakt i paligjshëm me dëshmitarët *domosdoshmërisht* do të pengonte hetimet dhe ndjekjet penale, dhe se për këtë arsye është e panevojshme të jepen hollësi në Aktakuzë”.⁷⁹ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, një i akuzuar, për shembull, mund të kontaktojë një dëshmitar të ditur të ZPS-së për një çështje personale që nuk ka aspak lidhje me procesin gjyqësor.⁸⁰

53. Ka dy aspekte në argumentin e z. Thaçi që duhen sqaruar. Ato trajtohen me radhë më poshtë.

54. Së pari, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se z. Thaçi është informuar plotësisht dhe me hollësi për kohën e vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit të DHS-së, personat e pranishëm dhe përmbajtjen e bisedave. Konkretisht, z. Thaçi është informuar plotësisht se gjatë secilës prej këtyre vizitave jo të privileguara, pretendohet se u dha të bashkakuzuarve përkatës udhëzime që duhej t’ua përcillnin dëshmitarëve (të mbrojtur) të ZPS-së në Çështjen 06 për mënyrën se si të dëshmonin.⁸¹ Në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes së Thaçit, Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar ka të bëjë me kontaktet e *paligjshme* të z. Thaçi me dëshmitarët, e jo me kontaktet e ligjshme. Në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar parashtrohet qartë se z. Thaçi u përpoq t’u përcillte dëshmitarëve

⁷⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 13.

⁸⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 13.

⁸¹ *Shih* Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, para. 9, 16-17, 21, 26.

mesazhe lidhur me dëshmitë e tyre të pritshme para DHS-së, dhe jo lidhur me ndonjë “çështje personale që nuk ka aspak lidhje me procesin gjyqësor”.⁸² Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk është bindur se z. Thaçi nuk kupton se *cili* kontakt i paligjshëm është pjesë e akuzave.

55. Së dyti, duket se z. Thaçi kërkon të dijë se *si* sjellja e tij do të parandalonte ose pengonte zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave të tyre.⁸³ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se z. Thaçi akuzohet për *tentativë* për pengim të zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kontekst të Çështjes 06,⁸⁴ që do të thotë se nuk është përmbushur vepra penale e pengimit. Për rrjedhojë, është e qartë se ZPS-ja nuk ka nevojë të demonstrojë se si veprimet e z. Thaçi *faktikisht* penguan ose parandaluan kryerjen e detyrave të zyrtarëve (të caktuar) të DHS-së/ZPS-së.⁸⁵

56. Si përfundim, ajo që ka rëndësi për përmbushjen e kriterëve të njoftimit është që Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar përmban pretendimet faktike në lidhje me sjelljen e zotërinjve Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj, të përshkruar në paragrafët 9-12 dhe 16-22 të dokumentit akuzues, përmes së cilës ata tentuan të pengonin kryerjen e detyrave të personave zyrtarë në kontekst të Çështjes 06. Ky është fakt. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Thaçi është i pabazë.

⁸² Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 13.

⁸³ *Shih* Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit, para. 21-22.

⁸⁴ *Shih më lart*, para. 48.

⁸⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit duket se keqinterpreton Vendimin e Konfirmimit kur argumenton se “Gjykatësja e Procedurës Paraprake ishte e detyruar ... të spekulonte për mënyrat e pengimit që ishin të mundshme” (*shih* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 14). Kjo është e pasaktë. Në atë kohë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se parashtrimet e ZPS-së për provat ishin të pamjaftueshme për të konstatuar se veprimet e z. Thaçi dhe të të bashkakuzuarve kishin *penguar* punën e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kuadër të procesit të DHS-së (Vendimi i Konfirmimit, para. 192). Sidoqoftë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se veprimet e tyre “në parim, mund të rezultoj[n]ë në pengim të punës së zyrtarëve të ZPS-së/DHS-së, në veçanti të prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së, në kuadër të procesit të DHS-së” (Vendimi i Konfirmimit, para. 193) dhe konfirmoi tentativën për pengim. Përdorimi i fjalëve “në parim” synonte posaçërisht të theksonte natyrën *tentuese* të veprimeve të të akuzuarve.

5. Paraqitja e veprimit të përbashkët

57. Mbrojtja e Thaçi ankohet se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar nuk shpjegohet se cila sjellje e të akuzuarve, ose e tre grupeve, përbën “veprim të përbashkët” përmes së cilit është tentuar pengimi.

58. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se “veprimi i përbashkët mund të përfshijë çdo veprimtari që ndërmerret bashkërisht nga anëtarët e grupit. Çka është më e rëndësishme, neni 401(2) i KPK-së ndëshkon çdo veprim të kryesit, që merr pjesë në grup, kontribuon në të ose mundëson në ndonjë formë tjetër veprimin e përbashkët; neni nuk kërkon që veprimet e secilit pjesëmarrës në grup të kontribuojnë drejtpërdrejt në qëllimin pengues”.⁸⁶

59. Sikurse me paraqitjen e veprimeve penguese, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e z. Thaçi është informuar plotësisht dhe me hollësi për kohën e vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit të DHS-së, personat e pranishëm dhe përmbajtjen e bisedave. Nëse kontributet e zotërinjve Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj përmbushin ose jo kriterin ligjor të “veprimit të përbashkët”, është një aspekt që do të diskutohet gjatë gjykimit bazuar në provat. Ajo që ka rëndësi për përmbushjen e kriterëve të njoftimit është që Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar përmban pretendimet faktike në lidhje me sjelljen e zotërinjve Thaçi, Fazliu, Smakaj dhe Kilaj, të përshkruar në paragrafët 9-12 dhe 16-22 të dokumentit akuzues, që mund të përbëjë “veprim të përbashkët”. Ky është fakt. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Thaçi është i pabazë.

⁸⁶ Vendimi i Konfirmimit, para. 52. *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykses II, [Public Redacted Version of Trial Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit), 18 maj 2022, publik, para. 162 (“Rrjedhimisht, “veprimi i përbashkët” sipas nenit 401(2) të KPK-së nuk mund të kufizohet në dhunën e “turmes”, por përfshin në parim çdo lloj veprimtarie kriminale të përbashkët që kërkon arritjen e qëllimit pengues përkatës”).*

6. Paraqitja e sjelljes së z. Fazliu

60. Mbrojtja e Fazliut ankohet se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar nuk përcakton me qartësi veprimet e z. Fazliu që lidhen me dëshmitarin 1, veçanërisht jashtë objektit të paraburgimit të DHS-së.

61. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar përmban në paragrafët 9-12 informacion në lidhje me: (i) vizitën jo të privilegjuar të z. Fazliu të 2 korrikut 2023 të z. Thaçi në objektin e paraburgimit të DHS-së; (ii) dhënien e informacionit konfidencial nga z. Thaçi lidhur me dëshmitarët e ZPS-së në Çështjen 06 dhe udhëzimet e tij për t'iu përcjellë dëshmitarit 1; (iii) skemën se si mesazhet do t'i përcilleshin dëshmitarit 1, konkretisht përmes djalit të z. Fazliu; (iv) kohën dhe rrethanat e dëshmisë së dëshmitarit 1 në Çështjen 06; dhe (v) veprimet e z. Fazliu para dhe pas vizitës së 2 korrikut 2023 në objektin e paraburgimit të DHS-së. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se z. Fazliu ka marrë transkriptin e plotë të vizitës së 2 korrikut 2023 që ofron hollësi të mëtjshme lidhur me elementet e parashtuara në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake pajtohet me Mbrojtjen e Fazliut se veprimet e z. Fazliu para dhe pas vizitës së 2 korrikut 2023 janë relevante për pretendimet e tentativës për pengim.⁸⁷ Për këtë arsye, ato përmenden në paragrafin 10 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, dhe plotësohen më tej në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3), dhe me provat e nxjerra (ndër të tjera, transkriptet e vizitës së 2 korrikut 2023 dhe të dhënat e nxjerra nga një telefon mobil i sekuestruar). Nëse provat mjaftojnë apo jo që z. Fazliu të mbahet përgjegjës, është një aspekt që do të diskutohet gjatë gjykimit bazuar në provat.⁸⁸ Ajo që ka rëndësi për përmbushjen e kritereve të njoftimit është

⁸⁷ *Shih* Mocionin e Mbrojtjes së Fazliut, para. 11.

⁸⁸ Duket se Mbrojtja e Fazliut e kupton argumentin e vet se lidhet me provat kur shprehet se ZPS-ja “nuk mund të mbështetet në *dobësitë e hetimit të vet* për të përshtatur argumentet dhe provat kundër z. Fazliu gjatë zhvillimit të gjykimit” (theksimi i shtuar); *shih* Mocionin e Mbrojtjes së Fazliut, para. 11.

që Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar përmban pretendimet faktike në lidhje me sjelljen e z. Fazliu, të përshkruar në paragrafët 9-12 të dokumentit akuzues. Ky është fakt dhe, bazuar në këtë informacion, z. Fazliu mund ta përgatisë si duhet mbrojtjen e tij. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Fazliu është i pabazë.

7. Tentativa për pengim: Njoftimi i duhur i z. Fazliu dhe dispozitat ligjore përkatëse

62. Mbrojtja e Fazliut pretendon se në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar nuk është paraqitur me konkretësi se cili kryes pretendohet të ketë filluar të kryejë cilat elemente materiale dhe se si kjo sjellje nuk përbënte kryerje të plotë. Mbrojtja pretendon se nuk mund të pritët që z. Fazliu të bëjë hamendësime për të përcaktuar natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij, ose për të përgatitur linja alternative të mbrojtjes.⁸⁹ Mbrojtja gjithashtu pretendon se neni 28 i KPK-së duhej të ishte përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, që do të sqaronte paqartësitë në lidhje me relevancën e dispozitave ligjore dhe do t'i mundësonte z. Fazliu që të përgatiste mbrojtjen si në lidhje me provat, ashtu edhe me dispozitat ligjore përkatëse.⁹⁰

63. Sa i takon argumentit se z. Fazliu nuk është informuar mjaftueshëm se si ai vetë, djali i tij dhe z. Thaçi kanë kontribuar në *tentativën* për pengim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se i gjithë informacioni i nevojshëm që tregon veprimet e tyre për kryerjen e një vepre penale pa përmbushur elementet e saj, gjendet në paragrafët 9-12 të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, plotësuar nga Përmbledhja sipas Rregullës 86(3) dhe provat e nxjerra. Sidoqoftë, është e paqartë se si Mbrojtja e Fazliut mund të pretendojë që është e detyruar të bëjë hamendësime në lidhje me natyrën dhe shkakun e akuzave kundër z. Fazliu. Ajo që ka rëndësi për përmbushjen e kriterëve në lidhje me njoftimin është që Aktakuza e Konfirmuar e

⁸⁹ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 15.

⁹⁰ Mocioni i Mbrojtjes së Fazliut, para. 16.

Ndryshuar përmban pretendimet faktike në lidhje me sjelljen e z. Fazliu, të përshkruar në paragrafët 9-12 të dokumentit akuzues. Ky është fakt dhe, bazuar në këtë informacion, z. Fazliu mund ta përgatisë si duhet mbrojtjen e tij në lidhje me provat. Vlen të theksohet se është përgjegjësia e mbrojtësit të hartojë strategjinë e mbrojtjes.

64. Sa i takon argumentit se neni 28 i KPK-së duhet të përfshihet në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar bashkë me nenin 401(2) të KPK-së, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se ky aspekt është diskutuar dhe për të është marrë vendim në Vendimin e Konfirmimit.⁹¹ Formulimi i nenit 401(2) të KPK-së (“pengon ose tenton të pengojë”) tregon se vepra penale mund të kryhet *ose* kur pengimi është kryer, *ose* kur vetëm është tentuar. Rrjedhimisht, në kontekstin e nenit 401(2) të KPK-së, “tenton të pengojë” është një formë e kryerjes. T’i shtosh nenit 401(2) të KPK-së nenin 28 të KPK-së do të thotë të paraqesësh një *tentativë* të *tentativës* për pengim. Ky interpretim është ligjërisht i pabazë. Për mendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, dhe në kundërshtim me kërkesën e Mbrojtjes së Fazliut, formulimi i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar është ligjërisht i qartë dhe jo i dykuptimtë, dhe nuk ka nevojë të ndryshohet. Nëse z. Fazliu dëshiron të kundërshtojë më tej interpretimin e nenit 401(2) të KPK-së, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se kundërshtimet në lidhje me elementet ligjore të një vepre penale nuk përbëjnë kundërshtime ndaj formës së Aktakuzës, por janë aspekte që trajtohen gjatë gjykimit.⁹² Rrjedhimisht, duke marrë parasysh sa më lart, argumenti i z. Fazliu është i pabazë.

⁹¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 51 (me referencat e mëtejshme të cituara aty), 260, 304.

⁹² *Shih më lart* para. 35.

V. VENDIM

65. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **RRËZON** Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit;
- b. **RRËZON** Mocioni e Mbrojtjes së Fazliut; dhe
- c. **RIKUJTON** se për këtë vendim zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77 të Rregullores.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E martë, 24 qershor 2025

Në Hagë, Holandë.